

Nr. 06/ZDP/VE/2020

Datë: 22 maj 2020

Në mbështetje të nenit 14.1, 14.2, 15.1 (f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, 4 qershor 2008), dhe nenit 13.1 të Rregullores së AAC-së nr. 3/2015 mbi tarifatat e aeroportit, datë 8 qershor 2015,

Duke vendosur sipas propozimit të operatorit të aeroportit, LKIA ANP "Adem Jashari" ("operatori i aeroportit"), dt. 12 shkurt 2020, për aprovim të Programit Nxitës 2020-2022 dhe verzionit të amandamentuar të Programit Nxitës 2020-2022 të dorëzuar më 26 shkurt 2020;

Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës nxjerr këtë:

VENDIM

1. Aprovohet Programi Nxitës 2020-2022 për ANP "Adem Jashari" sipas propozimit të operatorit të aeroportit, dt. 27 shkurt 2020 me nr. protokoli 2020/04/67, në përputhje me këtë vendim dhe për periudhën 22 maj 2020 deri më 26 mars 2022.
2. Miratimi i pikës 6.4 -*Nxitja për shërbime të kufizuara në tokë* e përfshirë në Programin Nxitës nga pika 1 e këtij Vendimi është jashtë kompetencave të AAC-së.
3. Çdo ndryshim i Programit Nxitës duhet të bëhet në pajtim me Rregulloren nr. 3/2015 mbi tarifatat e aeroportit.
4. Obligohet operatori i aeroportit që t'ua ofrojë Programin Nxitës të gjitha kompanive ajrore që operojnë në ANP "Adem Jashari", në mënyrë jo-diskriminuese dhe ta publikojë këtë program në mënyrë të përshtatshme, si dhe të informojë AAC-në mbi zbatimin e këtij programi dhe ndonjë ndryshim eventual të tij.
5. Kompanitë ajrore mund të ankohen në AAC në rast se janë të pakënaqur me zbatimin e Programit Nxitës nga operatori i aeroportit.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Operatori i aeroportit ka dorëzuar Programin Nxitës 2020-2022 për marrjen e aprovimit nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ("AAC") më dt. 12 shkurt 2020.

Në Programin Nxitës thuhet se ai ka për qëllim rritjen e trafikut në këtë aeroport përmes nxitjes për zhvillimin e destinacioneve të reja, nxitjes për zhvillimin e frekuencave shtesë, nxitjes për kompanitë që e stacionojnë së paku një aeroplan në Prishtinë dhe nxitjes për kompanitë që shfrytëzojnë shërbime të kufizuara në tokë.

Me qëllim të marrjes së aprovimit të AAC-së për programin e tij nxitës, operatori i aeroportit ka dorëzuar këto dokumente për shqyrtim:

1. Komunikimin elektronik të datës 21 shkurt 2019 prej LKIA te kompanitë ajrore me titull "Draft incentiva e PIA 2019-2020", përmes të cilit kërkojnë komentet në programin nxitës 2019-2020 deri më 28 shkurt 2019;
2. Listën e pranuesve të komunikimit të lartë përmendur;
3. Përgjigjen përmes emailit nga kompania EasyJet të datës 22 shkurt 2019;
4. Përgjigjen përmes emailit nga kompania TUI fly Belgium të datës 26 shkurt 2019;
5. Përgjigjen përmes emailit nga kompania Edelweiss të datës 28 shkurt 2019.
6. Përgjigjen përmes emailit nga LKIA lidhur me programin e nxitjes së vitit 2019 të konsultuar me kompanitë ajrore të datës 21 shkurt 2020; dhe
7. Programin e amandamentuar me nr. prot. 2020/04/67 dt. 27.02.2020 sipas konkluzioneve të takimit midis AAC-së dhe LKIA-së të datës 26 shkurt 2020.

Në bazë të detyrave dhe përgjegjësiive të AAC-së sipas nenit 15(f) të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil si dhe nenit 13.1 të Rregullores nr. 3/2015 për tarifatat e aeroportit, AAC-ja ka bërë shqyrtimin e këtyre dokumenteve dhe

KA KONSTATUAR SE:

- Programi nxitës i propozuar për sa i përket produkteve nxitëse 6.1-6.3 është i ngjashëm me Programin që aktualisht është në fuqi;
- Programi nxitës i propozuar është një iniciativë transparente dhe inkurajim për kompanitë ajrore që të fillojnë destinacione/frekuenca të reja ose të shtojnë vëllimin e trafikut ekzistues nga ANP "Adem Jashari". Zbatimi i këtyre nxitjeve gjatë viteve të kaluara ka treguar të jetë i dobishëm për publikun ngase janë rritur mundësitë për të udhëtuar nga ANP "Adem Jashari";

- Kushtet për dhënien e nxitjeve nr. 6.1, 6.2 dhe 6.3 të ofruara në Programin Nxitës të propozuara nga operatori i aeroportit e të cilat rregullohen nga AAC-ja janë relevante, objektive dhe transparente;
- Programi Nxitës i ofrohet të gjitha kompanive ajrore pa asnjë përjashtim të cilat bartin udhëtarë dhe operojnë ose planifikojnë të operojnë nga ANP “Adem Jashari” dhe të cilat plotësojnë të gjitha kushtet;
- Programi Nxitës është i limituar në kohë në periudhën 29 mars 2020 – 26 mars 2022. Sidoqoftë për shkak të gjendjes së emergjencës shëndetësore të shpallur në mars të vitit 2020, programi mund të jetë efektiv pas hapjes së kufinjve ajrorë kur pritet të fillojnë operimet në aeroport;
- Edhe pse konsultimi me kompanitë ajrore për këtë program është bërë para një viti, është i pranueshëm për AAC-në sepse produktet dhe kriteret kanë mbetur të njëjta dhe në bazë të listës së kompanive ajrore të konsultuara është vërtetuar se janë konsultuar të gjitha që operojnë momentalisht në aeroport;
- LKIA ka pranuar të ndryshojë propozimin që të mirren parasysh dy rekomandime të AAC-së të prezantuara gjatë takimit të datës 26 shkurt 2020:
 - Të ndryshohet kriteri në të tri produktet që ka të bëjë me peshën e aeroplanit nga 55,000 kg në 21,000 kg siç ka qenë në programet e kaluara në mënyrë që të mos diskriminohen kompanitë ajrore që nganjëherë operojnë edhe me aeroplanë me peshë më të vogël se 55,000 kg;
 - Të ndryshohet kriteri në të dy produktet (6.1 dhe 6.2) që ka të bëjë me përqindjen e frekuencave të operuara respektivisht nga 95% në 90% sepse kështu ka qenë e propozuar në verzionin e konsultuar.

Duke marrë parasysh se Programi Nxitës i operatorit të aeroportit ANP “Adem Jashari” ka për qëllim promovimin e hapjes së destinacioneve të reja dhe rritjes së numrit të fluturimeve, është i kufizuar në kohë (vlen për dy vite) dhe është proporcional me arritjen e objektivit të synuar, mund të përfundohet se, si i tillë, ky program është në interes të përgjithshëm publik dhe në përputhje me kërkesat e nenit 13.1 të Rregullores nr. 3/2015 për tarifën e aeroportit.

Përjashtimisht, miratimi i pikës 6.4 i Programit Nxitës nuk është në kompetencë të AAC-së sipas Rregullores nr. 3/2015. Kjo nxitje implikon tarifën për shërbime në tokë që nuk janë tarifa të rregulluara aeronautike të listuara në nenin 4 të Rregullores nr. 3/2015 të AAC-së. Është në diskrecionin e operatorit të aeroportit të ofrojë nxitje për shërbimet në tokë, në pajtim me Rregulloren nr. 4/2011 të AAC-së për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë të amandamentuar. Sidoqoftë, nxitja për kompanitë ajrore sipas pikës 6.4 të Programit Nxitës të referuar më lart, duhet t’u ofrohet në mënyrë jodiskriminuese të gjitha kompanive që i plotësojnë kushtet e përcaktuara nga operatori i aeroportit.

Përmes korrespondencës elektronike në lidhje me kërkesën e AAC-së për të marrë pajtueshmërinë nga Partneri Publik rreth Programit Nxitës të propozuar nga operatori i aeroportit, Departamenti Qendror për Partneritet Publiko Privat i Ministrisë së Financave më dt. 04 mars, 2020 ka këshilluar AAC-në të vazhdojë ushtrimin e përgjegjësisë të AAC-së

brenda kompetencave të parapara me Ligjin për Aviacionin Civil dhe aktet nënligjore përkatëse si dhe Kontratës së PPP për koncesionimin e aeroportit. E drejta e operatorit privat që të ofrojë nxitje në tarifën e rregulluara rrjedh nga Neni 6.3 (b) i Kontratës së PPP për koncesionimin e aeroportit.

Përmes Vendimit nr. 09/2020, Komisioni i Ndihmës Shtetërore më 21 maj 2020 ka vendosur që masa e ndihmës "Programi nxitës 2020/2022 për kompanitë ajrore që operojnë në ANP "Adem Jashari", e njoftuar për shqyrtim dhe vendim nga Ministria e Financave dhe Transfereve dhe Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) - nuk përbën ndihmë shtetërore - në kuptimin e Ligjit 05/L-100 për Ndihmën Shtetërore, neni 3 (1.1), duke qenë se nuk përmbushë kriteret në kumulativ, dhe rrjedhimisht nuk i nënshtrohet parimit të përgjithshëm të ndalimit.

Prandaj, në bazë të këtyre fakteve, mund të konkludohet se Programi Nxitës i operatorit të aeroportit është në përputhje me kërkesat e nenit 13.1 të Rregullores nr. 3/2015 për tarifën e aeroportit.

Duke u mbështetur mbi këtë bazë ligjore, Drejtori i përgjithshëm ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 22 maj 2020


Arianit Islami
U.D Drejtor i përgjithshëm

Udhëzim mbi mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të kërkohet rishikim administrativ pranë Komisionit të Ankesave të AAC-së, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Iu dërgohet:

Operatorit të ANP "Adem Jashari"
Departamentit Qendror PPP, Ministria e Financave
Departamentit të Aviacionit Civil, Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit